



## Reduktimi i kontributit te sigurimeve shoqerore nepermjet zgjerimit te bazes se kontribuesve

Ne kohen qe jetojme, ne situata te ndryshme te ciklit te zhvillimit te jetes nder te tjera jo per shkak te gabimeve te tyre personale njerzit do te gjenden perballe situatave qe kerkojne shpenzime te shumta e afat gjata dhe qe mund te jene te paperballueshme.

Sidomos keto shpenzime jane te paperballueshme ne rastet e pamundesise per te punuar per shkak te moshes madhore, te semundjeve, etj. Ne keto raste del ne plan te pare mbrojtja e pergjitheshme sociale dhe ne veçanti mbrojtja ekonomike nga sigurimet shoqerore.

Por siç eshte e qarte nga te gjithë, sistemet e sigurimeve, qofshin te skemave te solidaritetet apo te skemave te tjera suplementare, kane si kusht kryesor **pjesmarjen** çka do te thote qe te perfitosh ne radhe te pare duhet te sigurohesh, pra te kesh paguar kontribute per nje periudhe te percaktuara.

Por nga ana tjeter eshte i kuptueshem edhe fakti se qe te kerkosh jesh pjesmares ne nje sistem sigurimesh, ne radhe te pare ai vete , pra sistemi:

- duhet te jete i drejte qe do te thote te te ktheje te rivleresuar ate cfare eshte paguar
- kontributet periodike qe paguhet te jene te arsyeshme dhe te perballueshme ne te kundert ato behen burim i evazionit dhe ne vend qe te forcojne sistemin e minojne ate.

Mbi bazen e ketyre koncepteve rrjedh domosdoshmerija e administrimit korekt, me pergjegjesi dhe ne menyre te harmonizuar te gjithë sistemit, ne te gjitha hallkat dhe agregatet e tij, jo vetem duke kerkuar qe çdo brez, te beje detyren si ndaj brezit te shkuar ashtu edhe per te ardhmen e tij por nga ana tjeter edhe duke vendosur norma te tilla PRIMESH (kontributesh) e perfitimesh te cilat te jene te perballueshme e te pranueshme, te mos nxisin informalitetin dhe te jene bashkeudhetare te nje punesimi normal.

Deri ne vitet 91, gjithë veprimtaria ekonomike e vendit drejtohej ne menyre te centralizuar.

- Shteti totalitar, kontrollonte gjithë veprimtarine prodhuese e shoqerore te vendit, me te gjithë elementet perberes te saj.

- Nder te tjera ndermjet politikave te veçanta te punesimit dhe rishperndarjes me ose pa efektivitet, kontrollonte totalisht tregun e punes dhe ne keto kushte pothuaj nuk behej fjale per veprimtari informale.
- Ne realizim te kontrollit te pergjithshem, shteti organizonte dhe zbatonte nje sistem te plote statistikor nder te cilat nje pjese e informacionit mbahej sekret duke mos publikuar shifra per papunesine, vdekshmerine, pagat dhe te ardhurat reale. Megjithkete veprimtaria informale ishte totalisht e kontrolluar dhe ne kufijte jashtezakonisht minimale.
- Nga ana tjetere nepermjet normes se planifikuar te kontributit e cila indirekt ishte pjese e koston dhe element i çmimeve te planifikuara dhe totalisht te kontrolluara siguroheshin fondet relativisht te decentralizuara e me perdorim qellimor te cilat financonin sistemin e pensioneve.
- Kjo norme kontributesh rezulton te jete rritur ne menyre graduale sipas nevojane per fonde te cilat kondicionohen kryesisht nga shtesa e vazhdueshme e numrit te perfituesve.
- Ne nje veshtrim retrospektiv na rezulton se norma e kontributit ndaj pages fillon me 8% rritet gradualisht ne vite deri sa ne ditet e fundit te sistemit te centralizuar arrin ne 25%.

**Tabela e kontribuesve dhe perfituesve ne vite- deri ne 1992.**

**Kontribues, perfitues shkalla e vartesisë dhe norma e kontributit  
1972-1991**

<i>Vitet</i>	<i>kontribues</i> <i>persona</i>	<i>pensioniste</i> <i>persona</i>	<i>rap/vart</i>	<i>norma</i> <i>ne %</i>
1972	626,953	68,216	0.11	8
1973	639,088	74,325	0.12	9
1976	520,150	91,164	0.18	11
1979	591,287	107,614	0.18	13
1983	685,296	140,072	0.20	15
1986	750,982	163,790	0.22	19
1888	829,500	184,215	0.22	21
1990	846,212	208,416	0.25	23
1991	785,616	250,150	0.32	25

Elementet e informalitetit dhe evazionit te kontributeve jane cfaqur totalisht pas viteve 1991 me fillimin e tranzicionit nga ekonomia e centralizuar ne ekonomine e tregut . Fillimisht keto elemente nuk lidhen me normen e larte te kontributeve pasi ne kushtet e zhvillimeve te atehereshme perdominonin faktore te tjere.

Analiza e zhvillimeve makroekonomike te kesaj periudhe nxjerr ne pah;

- renien drastike te Prodhimit te Brendshem Bruto (PBB) ne vitet 1990-1993, fillimin e stabilitetit dhe te nje ngritje graduale te tij deri ne vitin 1996,
- kolapsin e vitit 1997,
- si dhe nje shkalle te ulet te rikuperimit te saj gjate viteve te tjera.

Ne periudhen 1991-1993 si shkak i mos mbijeteses te ish ndermajeve socialiste ne kushtet e ekonomise se tregut, renjes dhe falimentit te tyre te njepasnjeshem, filloj te zhvillohet nje ekonomi fregmentare me nje treg pune shume heterogjen te paqendrushem dhe te paevidentuar. Kjo beri qe papunesia te rritet ne menyre galopante e ne permasa te medha, duke e ngushtuar dukshem bazen e kontribuesve ne skemen e sigurimeve.

Ne vitin 1994 numri i kontribuesve zbriti ne 1/3 e numrit te vitit 1990. Megjithkete duhet te cilesojme edhe faktin tjetër se pergjithesish edhe ata qe evidentohen si kontribues me shume jane punonjes publike ose punetore ne ndermarje shtetore qe vetenm vegjetojne.

**Tabela e kontribuesve te periudhes 1990-1994.**

<i>Vitet</i>	<i>buxhetore</i>	<i>jo buxhetore</i>	<i>firma private</i>	<i>te vetpunesuar</i>	<i>ne bujqesi</i>	<i>te tjera</i>	<i>shuma</i>
1,990	252,000	594,212	0	0	605,000	0	1,451,212
1,991	248,000	537,616	0	2,000	560,000		1,347,616
1,992	248,000	362,000	15,000	35,000	500,000		1,160,000
1,993	218000	135000	40,000	37,000	400,000	261,000	1,091,000
1,994	148,585	131,158	44,505	41,251	400,000	94	765,593

*Ne vitin 1993, 261 000 persona trajtoheshin me kompensim papunesie*

Nga fillimi i viti 1994 dhe deri ne vitin 1996 ne menyre graduale fillon stabiliteti dhe reformat ekonomike te ndermara, bene te mundur qe:

- Si edhe per shume fusha te tjera me asistencen e Bankes Boterore u hartua nje ligj i ri per sigurimet shoqerore
- te filloje stabiliteti i te punesuarve dhe ne numrin e kontribuesve megjithese ky i fundit perseri te ishte i ulet,
- filluan qe te arketohen ne fondin e sigurimeve shoqerore kontribute nga subjekte qe i rezistuan reformes
- kontribuojne kontributet e arketuara ishin reale dhe financonin shpenzimet e nje buxheti te pavarur nga buxheti i shtetit.

- shkalla reale e mbulimit që përfaqëson raportin ndërmjet kontribuesve dhe forcave të punës arrin realisht në 34%.
- ndërkohe si rezultat i krizës në vitin 1997 raporti ndërmjet kontribuesve dhe forcave të punës zbriti në 26,7 %.

Ne të nejtën kohë,

- mbyllja masive e ndërmarrjeve dhe e sektoreve shtetërore të prodhimit dhe të shërbimeve jo rentabile
- mungesa e legjislacionit dhe rregullave adekuate të ekonomisë së tregut,
- mungesa e infrastrukturës kontrolluese dhe eksperiencës për dhe kulturës qytetare për të paguar detyrimet tradicionale,

u shoqëruan me rritjen e ndjeshme të sektorit informal në ekonomi, duke ndikuar në reduktimin e të ardhurave të buxhetit të ISSH-se.

Numri mesatar vjetor i kontribuesve, përjashtuar bujqësinë, në vitet e parë të zbatimit të skemës ka pësuar rënie duke shënuar kulmin në 1997, ndërsa, me pas vërehet prirja e rritjes graduale të numrit të kontribuesve.

- në 2002 ky numur arriti në 342 mijë,
- në fund të vitit 2005 arrin 362 mijë dhe
- në muajin gusht 2006 ariti në mbi 386 mijë persona .
- Në sektorin privat numri i kontribuesve ka arritur në mbi 190 mijë persona me një shtesë prej 38 mijë kontribuesish ose 26.7%

### **Tabela për ecurinë e kontributeve në vitet 2002-2006.**

Në situatën aktuale megjithë përmirësimet ndjeshme të shënuara vlerësohet se pjesëmarrja e popullsisë në skemën e sigurimeve shoqërore vazhdon të jetë relativisht e ulët, me e theksuar paraqitet kjo dukuri në zonën rurale. Megjithatë me avantazh demografik krahasuar me disa vende të tjera perseri raporti kontribues përfitues në Shqipëri është në nivelet rreth 1 me 0.84. e si pasojë edhe pensionet janë të ulta e për ndonjë kategori pensionistësh edhe nën minimumin jetik. Mbi këto dukuri negative ka ndikuar:

- mungesa e informacionit të kombinuar të efektivitetit të veprimtarisë së ndërmarrjeve, kontrolli rrigoroz i subjekteve ekonomike aktive, uniformizimi i tregut të punës dhe pagesave çka e ka ulur disi edhe efektivitetin e përpjekjeve të bëra në drejtim të minimizimit të evazionit në skemën e sigurimeve shoqërore.
- mungesa e evidentimit të levizjeve të popullsisë, sidomos e levizjeve hapësinore, informaliteti në industrinë e ndërtimit etj. Dihet se tranzicioni u shoqërua me disekuilibër të papare në zhvillimet demografike. Ato lidhen, nga një anë, me ndryshimet e vullshme e kaotike të ndodhura në levizjen natyrore e sidomos në atë hapësinore, me emigrimin dhe me levizjet mekanike të brendshme në permasa të mëdha e të papara ndonjëherë.

- Ne baze te kontrolleve te ushtruara rezulton se i shmangen regjistrimit ne sigurimet shoqerore dhe per pasoje edhe pageses se kontributeve rreth 21% e personave te vetpunesuar ne subjektet fizike nderkohe qe nuk paguajne sigurimet shoqerore rreth 18-20 % e personave te punesuar ne ndermarjet private.
- Eshte konstatuar se ka diferenca midis subjekteve qe jane te licensuara dhe atyre qe paguajne kontribute gje qe sjelle ne konkluzion mangesi ne organizimin e kontrollit, ballafaqimit te informacionit te brendeshem ashtu edhe ne beshkepunimin midis administarave.
- Ka shume subjekte qe zhvillojne aktivitet jo bujqesor ne zonat rurale te cilet nuk regjistrohen, duke ushtruar veprimtari ekonomike te pa licensuar e per pasoje nuk paguajne kontribute.
- I shmangen ne menyre te rregullt regjistrimit ne zyrat e punes dhe ne sigurimet shoqerore punonjesit qe punojne ne kikonstruksionet e banesave shtesave ne artizanat, ne punetoret qe marin dhe kryejne pune ne shtepi dhe sidomos kur punet qe kryejne jane te perkoheshme.
- Realizohet me mangesi te theksuara inspektimi i subjekteve sidomos kontriolli i te gjitha librave dhe rekordeve te punedhenesit.
- Nga ana e punedhenesve hartohen e paraqitet perpara organeve te kontrollit te dhena jo reale si per numrin e punonjesve ashtu edhe per pagen qe mer secili i punesuar duke ulur keshtu ne menyre abuzive detyrimin per te paguar.
- Ne krahasim midis numrit te kontribuesve ne qytet dhe forcave aktive po te qytetit egziston nje kategori e madhe njerzish qe punojne ne tregjet dirore dhe tezga te cilet nuk regjistrohen ne skemat e sigurimit qofte edhe per arsye te te ardhurave te pakta ditore qe realizojne nga ky aktivitet.

Nder te tjera ne inspektimet dhe intervistat me punedhenes edhe konstatuar pervec shume arsyeve nje nder faktoret e evazionit dhe informalitetit mbetet norma e larte e kontributit ndaj pages. Kjo norme e larte e kontributit e vendosur ne vitin 1994, megjithese e domosdoshme atehere, ka sjelle si pasoje;

- deformime te tregut te punes,
- shmangje nga pagesa e kontributit te te gjitha personave te punesuar
- mos deklarim te pagave reale mbi te cilat llogaritet e paguhet kontributi.

Nder te tjera ka arsye te besohet se kjo norme e larte e kontributit tashme eshte kthyer ne te kunderten e vet pra ne vend qe te financoje sistemin po perkeqeson financat e tij.

Sipas dispozitave te ligjit nr.7703, date 11.5.1993 “Per Sigurimet Shoqerore ne Republiken e Shqiperise” i cili filloi te zbatohet nga data 1.10.1993, per shkak te kolapsit ekonomik dhe rrenjes drastike te numrit te te punesuarve, fillimisht masa e kontributit ndaj pages u vendos ne nivelin 42.5 perqind.

Nderkohe ne vitin 2002, sipas dispozitave te ligjit nr.8889, date 25.4.2002 “Per disa shtesa e ndryshime ne ligjin nr.7703, date 11.5.1993 “ Per Sigurimet Shoqerore ne



**Te ardhura nga kontributet 2002-2005 ne milione leke**

<i>Vitet</i>	<i>buxhetore</i>	<i>jo buxhetore</i>	<i>firma private</i>	<i>te vetpunesuar</i>	<i>ne bujqesi</i>	<i>vullnetare</i>	<i>shuma</i>
2,002	12,707	4,914	<b>5,482</b>	<b>1,174</b>	<b>404</b>	261	24,942
2,003	14,037	5,852	<b>6,055</b>	<b>1,390</b>	<b>1,279</b>	247	28,860
2,004	15,584	5,668	<b>6,904</b>	<b>1,742</b>	<b>1,940</b>	273	32,111
2,005	16483	4881	<b>7,991</b>	<b>1,947</b>	<b>1,981</b>	260	33,543

Megjithkete reduktimin, zhvillimet e vitit te fundit evidentojne se:

**Se pari.** Megjithese ne vitin 2002 u aplikua nje ulje e ndjesheme e ngarkeses kontributive me rreth 9.4 %, perseri konstatohet se ende ajo mbetet mjaft e larte, madje me e larte nga ajo e vendeve te tjera perfshire ketu edhe vendet e Evropes Qendrore e Lindore qe ndodhen gjithashtu ne procesin tranzicionit drejt ekonomise se tregut. Per degen e sigurimit te pensione, qe eshte tregues me i bashkematshem per vendet e ndryshme rezulton se, nderkohe qe Shqiperia e ka mase kontributesh 29.9 % kundrejt pages bruto, disa vende te tjera e kane perkatesisht: Austria 22,8 %, Belgjika 16,36%, Çekia 26%, Gjermania 20,3%, Franca 16,45%, Greqia 20%, Hungaria 30.5%, Turqia 20%, etj.

**Se dyti.** Megjithese ne vitin e fundit jane vene re permiresime ne drejtim te uljes se evazionit te kontributeve dhe rritjes se te ardhurave, perseri shmangja nga pagesa e kontributeve mbetet ne nivele te larta. Sipas te dhenave te INSTAT per vitin 2005, ne sektorin privat te ekonomise, perjashtuar bujqesine, punojne mbi 217 mije persona, nderkohe aktualisht jane te evidentuar si kontribut pagues rreth 158 mije persona me nje evazion qe i kalon 39 % te numrit te personave te punesuar ne kete sektor. Ne kete rast besohet se nje nder shkaqet vazhdon te mbetet edhe ngarkesa e larte kontributive.

**Se treti.** Nga vezhgimet si dhe nepermjet anketimeve te kryera konstatohet se niveli i pagave reale me te cilat paguhen punonjesit ne subjektet e sektorit privat eshte i barabarte ose me i larte se ai i sektorit publik. Nderkohe sipas statistikave zyrtare te pagimit te kontributeve, rezulton se paga e raportuar e sektorit privat per efekt te pagimit te kontributit eshte rreth 34% me e ulet se ajo e sektorit shteteror. Edhe ne kete rast veç problemeve te tjera mendohet se ka ndikimin e vet edhe ngarkesa e larte kontributive.

**Se katerti.** Per shkak te mases se larte te kontributit , por edhe te kerkeses se larte per pune sidomos per pune te paspecializuar, shpesh konstatohen marveshje momentale midis punemaresit dhe punedhenesit, per te punuar “pa sigurim

shoqeror” ose duke raportuar paga me te ulta se pagesat realet. Kjo zgjidhje momentale sjell si pasoje jo vetem uljen e te ardhurave te skemes se sigurimeve por krijon pabarazi ne rezultatin e biznesit midis punedhenesve qe realizojne detyrimet e tyre kontributive dhe atyre qe nuk i realizojne apo edhe midis punetoreve qe i paguajne kontributet dhe atyre qe nuk i permbushin keto detyrime ligjore.

Ne konkluzion, sipas analizes se mesiperme por edhe nje sere faktoreve te konstatuar ne punen e perditeshme, si edhe ne vitin 2002, perseri mbetet te besohet se nje nga shkaqet e ketij evazioni shume te larte, si ne numer dhe ne bazen kontributive por edhe te deformimeve te konstatuara ne tregun e punes, mbetet te jete edhe masa ende e larte e kontributeve.

Ulja e saj jo vetem qe do te ndikojte ne uljen koston se punedhenesit, por mendohet do te rrise numrin e kontribuesve, mbulimin e te punesuarve me elemetet baze te sigurimit shoqeror ne periudha afatshkurtra dhe afatgjata, do te formalizojte tregun e punes dhe ne pergjithesi do te normalizojte veprimtarine e biznesit.

Ne keto kushte dhe ne perpjekjet e vazhdueshme te qeverise per formalizimin e tregut dhe rritjen e nivelit te punesimit, tashme eshte aprovuar edhe ligjerisht dhe nga 1.9.2006, masa e kontributit te sigurimit shoqeror ne pergjithesi eshte ulur me 9 njesi, duka kaluar nga 38.5 ne 29.5 perqind dhe duke prekur dy dege:

- Dega e sigurimit te papunesise, paksohet me 3 njesi duke bere qe nga kontributet e sigurimeve shoqerore te kesaj dege, te mbulohen shpenzimet per perfitime ne rast papunesie.
- Degen e sigurimit per pensione, paksohet me 6 njesi, duke bere qe te harmonizohet me mire masa e kontributit dhe periudha e sigurimit, me periudhen e perfitimit nga sigurimet shoqerore. Ne kete rast mbajme parasysh edhe faktin se gjendemi ne mesin e reformes se rritjes graduale te moshes se daljes ne pension ku moshja kufi eshte rritur me 2.5 vjet dhe gradualisht kalohet ne rritjen e plote me 5 vjet.

Keshtu, pas zbritjes me 9 %, masa e kontributit te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore, ndryshohet si vijon :

Deget e Sigurimit	Totali i mases se kontributit		
	Ishte	Behet	Reduktimi
Per paaftesi te perkohshme	0.8	0.8	0
Per barreindje	2.3	2.3	0
Per pensione	29.9	23.9	6
Per aksidente	0.5	0.5	0
Per papunesine	5.0	2.0	3
<b>TOTALI</b>	<b>38.5</b>	<b>29.5</b>	<b>9</b>
Sigurimi shendetesor	3.4	3.4	0
<b>Shuma</b>	<b>41.9</b>	<b>32.9</b>	<b>9</b>

Duke analizuar treguesit por duke mare ne konsiderate edhe eksperiencen e mepareshme, besohet se reduktimi i normes se kontributeve do te kete efekt ekonomik te dyaneshem.

- Nga nje ane, ne momentin fillestar do te ndikojne ne uljen e te ardhurave financiare ne skemen e sigurimeve shoqerore,
- Nga ana tjeter mendohet dhe besohet se kjo ulje do te kompesohet me kalimin e kohes permes rritjes se interesimit te te punesuarve dhe punedhenesve per t'u perfshire me gjere ne skemen e sigurimeve shoqerore.
- Duke qenese ky reduktim aplikohet ne normen e kontributeve qe paguan punedhenesi duke e lehtesuar ate me rreth 30 % ,parashikohet qe te kete nje rritje te ndjeshme dhe te shpejte edhe ne drejtim te punesimit.

Nga ana tjeter rritjes se interesimit per tu siguruar, do te duhet t'i paraprihet edhe me masa te tjera institucionale, organizative dhe shternguese te cilat do te formalizojne tregun si dhe do te rrisin treguesit e akumulimeve shoqerore ndaj Prodhimit te Brendeshem Bruto duke rrujtur dhe forcuar qendrueshmerine financiare te sistemit sigurimeve dhe duke mos rezikuar pagesat e pensioneve.

Ne vitet ne vazhdim kjo mase si dhe masat e tjera mbeshtetese do te bejne te mundur qe :

- Numri i kontribuesve ne sektorin privat nga viti ne vit te rritet me rreth 25 % dhe ne harkun e tre viteve te arrije mbi 335 mije persona ose 150 mije me shume se numri aktual i tyre.
- Gjithashtu parashikohet qe paga mbi te cilen sektori privat paguhan kontributet, te formalizohet dhe gradualisht te arrije pagen mesatare te ndermarjeve shtetere dhe ne harkun e tre viteve te pesoje nje rritje prej rreth 100 % ndaj asaj aktuale duke arritur 34 600 leke nga 17 mije leke qe eshte aktualisht.
- Mbi kete baze te ardhurat nga kontributet ne vitin 2007 parashikohen te arrijne rreth 39 miliard leke dhe keshtu brenda nje viti, nepermjet uljes se evazionit, kompensohet pothuajse gjithe efektin negativ per rreth 7.5 miliard leke qe vjen si pasoje e uljes se ngarkeses kontributive.
- Ne vitin 2008 dhe ne vijim nepermjet rritjes se punesimit dhe vazhdimet te uljes se evazionit, deri ne formalizimin e plote, arihet te sigurohet nje rritem normal i rritjes se te ardhurave me rreth 6.5 deri ne 8 miliard leke.
- Ky rritem i rritjes se te ardhurave kontributive ben te mundur te perballohen efektet e rritjes se pensioneve dhe plotesimin e objektivit qe pensionet e ulta te dyfishohen.

Per minimizimin e shkalles se evazionit ne skemen e sigurimeve shoqerore dhe per te garantuar rritjen e numrit te kontribuesve, krahas reduktimit te normes se kontributit kerkohet te merren nje sere masash. Midis tyre me te rendesishme gjykohen se jane:

- Intensifikimi i punes dhe permiresimi i dispozitave ligjore ne drejtim te zgjerimit te kompetencave te administrates Tatimore per inspektimin e rekordeve te punes se subjekteve dhe ballafaqimin e tyre me gjendjen reale te punesimit dhe pagave.
- Permiresimi i procedurave administrative duke ndertuar raporte me te drejta midis punes administrative dhe asaj operative.
- Rritja cilesore e veprimtarise se Drejtorise se Pergjitheshme te Tatimeve dhe ISSH-se per sensibilizimin dhe krijimin e nje opinionit publik te papajtueshem me shfaqjet e evazionit dhe te mospaguesimit te te punesuarve ne skemen e sigurimeve shoqerore, duke ngritur nje projekt te fuqishem per ndergjegjesimin e opinionit te gjere publik. Rol me te madh duhet te luajne gjithashtu organizmat e tjera specializuara shtetere si edhe sindikatat.
- Forcimi i sanksioneve ligjore kryesisht ato te karakterit ekonomik ndaj subjekteve qe nuk zbatojne detyrimet ligjore per sigurimin e te punesuarve.
- Permiresimi i kontrollit te sistemit te pagave duke percaktuar e ndare edhe te ashtuquajturen page minimale sipas degeve te ekonomise.

### Numri i kontribuesve ne vitet 2006- 2009

Vitet	buxhetore	jo buxhetore	firma private	te vetpunesuar	ne bujqesi	vullnetare	te tjera	shuma
2006	134,111	41,700	<b>122,903</b>	<b>60,533</b>	247,404	8,525	34,792	649,968
2007	133,916	41,724	<b>161,479</b>	<b>98,804</b>	249,292	8,999	33,269	727,483
2008	133,610	37,782	<b>180,830</b>	<b>110,650</b>	255,130	8,999	33,269	760,270
2009	133155	34219	<b>207,798</b>	<b>127,151</b>	263,882	8,999	33,269	808,473

### Te ardhurat per vitet 2006-2009

ne milione leke

Vitet	buxhetore	jo buxhetore	firma private	te vetpunesuar	ne bujqesi	vullnetare	shuma	ritmi i rritjes
2006	15,156	4,327	<b>9,543</b>	<b>2,979</b>	2,314	360	34,679	
2007	13,678	3,858	<b>14,055</b>	<b>4,593</b>	2,559	356	39,099	12.7
2008	15,608	4,028	<b>19,308</b>	<b>4,988</b>	2,719	370	47,021	20.3
2009	16341	3832	<b>25,499</b>	<b>6,164</b>	3,031	398	55,265	17.5